



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE
AGJENCIA SHTETËRORE PËR TË DREJTAT DHE MBROJTJEN E FËMIJËS

Nr. 188 Prot

Data 23/10, 2018

KONTRATË SHËRBIMI PASTRIMI

E lidhur sot në datë 23/10 / 2018, ndërmjet:

AGJENCISË SHTETËRORE PËR TË DREJTAT DHE MBROJTJEN E FËMIJËS, me adresë “Rruga e Durrsit”, Nr.83, Tiranë, përfaqësuar nga **znj. Alma Tandili**, Titullar i Autoritetit Kontraktor, që më poshtë do të quhet **“AUTORITETI KONTRAKTOR”**, dhe

Operatorit Ekonomik **Alpen Pulito shpk** me NIPT, K61516506H me adresë Rr. “Asti Gogoli”L Nr 14, Shkozë-Durrës që më poshtë do të quhet **“KONTRAKTORI”**.

Neni 1 Baza Ligjore

1.1 Kjo kontratë hartohet në bazë të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Rregullat e Prokurimit Publik”, i ndryshuar

Neni 2 Objekti i Kontratës

2.1 Objekti i kontratës është blerja e shërbimit të pastrimit për zyrat e Agjencisë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës.

Neni 3 Fillimi i Kontratës

3.1 Zbatimi i kontratës do të fillojë menjëherë pas nënshkrimit të kontratës deri më **31.12.2018**.

Neni 4 Afatet e Pagesës



4.1 Pagesa do të bëhet në monedhë Shqiptare.

4.2 Pagesa për shërbimin do të bëhet brenda datës 10 të cdo muaji.

4.3 Pagesa për shërbimet objekt i kësaj kontrate do të bëhet me urdhër-shpenzimi, në llogarinë e Kontraktuesit.

Neni 5 Vlera e Kontratës

5.1; **Vlera e kontrates 24750**(njezet e kater mij e shtatqind e pesdhjet) **lekë pa TVSH**

5.2 Vlera e mësipërme përfshin koston e kryerjes të shërbimit në përputhje me specifikimet e vendosura në Aneksin Nr.1 bashkëlidhur kësaj kontrate.

Neni 6 Të drejtat dhe detyrimet e Palëve

6.1 Kontraktuesi do të kryejë shërbimin 2 herë në javë (diten e merkre pas ores 16:00 dhe ditën e premte pas ores 14:00) sipas përcaktimeve në Aneksin Nr.1 bashkëngjitur kontratës.

6.2 Për kryerjen e shërbimit kontraktuesi do të përdorë materialet që disponon autoriteti Kontraktor dhe në rast mungese të ndonjë materiali do të përdorë materialet e veta brenda cmimit dhe vlerës së kontratës.

6.3 Për realizimin e shërbimit dhe për pranimin e tij do të mbahet proces-verbal në fund të cdo muaji, i cili do të firmoset nga përfaqësues të palëve dhe do të shoqërohet me faturën tatimore të kryerjes së shërbimit. Dokumentet do të jenë të vullosura dhe pa korigjime.

6.4 Komunikimi ndërmjet palëve do të realizohet me shkrim ose nëpërmjet postës elektronike.

6.5 Kontraktuesi duhet të pranojë kontroll të kryerjes së shërbimit nga përfaqësuesi i Autoritetit Kontraktor, në çdo kohë.

Neni 7 Zgjidhja e kontratës

7.1 Secila palë mund të tërhiqet nga Kontrata në rastet e parashikuara në këtë kontratë duke njoftuar palen tjetër 30 (tridhjetë) ditë para marrjes së vendimit dhe pasi të jenë shlyer detyrimet që kanë lindur nga realizimi i pjesshëm i Kontratës.

Neni 8 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve



8.1 Mosmarrëveshjet mes palëve lidhur me zbatimin e kushteve të kësaj kontrate kur nuk janë zgjidhur me pajtim, kompetente për zgjidhjen e konfliktit është Gjykata Administrative e Rrethit Gjyqësor, Tiranë.

Neni 9 Të Përgjithshme

9.1 Kjo kontratë hartohet në 4 (katër) kopje, nga të cilat 1 (një) kopje për Kontraktuesin dhe 3 (tre) kopje për Autoritetin Kontraktor.

Neni 10 Dokumente që i bashkëlidhen kësaj kontrate

Pjesë përbërëse e kësaj kontrate do të jete Aneksi Nr.1 bashkëlidhur kësaj kontrate

AUTORITETI KONTRAKTOR

KONTRAKTUESI

AGJENCIA SHTETËRORE PËR TË DREJTAT

DHE MBROJTJEN E FËMIJËS

Z. Rahmi Dajlani

Znj. Alma Fandili



ANEKSI 1

LISTA E SHERBIMEVE

Shërbimet e pastrimit për të gjitha ambientet e ASHDMF

1. Shërbime me frekuence javore

- Mbledhje dhe derdhje e mbeturinave
- zevendesim me qese i koshave (per tualet, zyra)
- Pastrimi i tavolinave dhe pajisjeve informatike mbi to
- Pastrimi i bibliotekave dhe mobiljeve te tjera
- Pastrimi i dyshemeve te te gjitha ambjenteve
- Larje e bordurave te dyshemese
- Pastrimi i EC-ve dhe dizinfektimi i tyre brenda dhe jashte
- Pastrimi i aksesoreve dhe mureve te tualetit (pllakave)
- Pastrimi i pasqyrës së tualetit
- Kontrolli dhe zevendesimi i materialve (leter higjenike, leter dhe likuid duarsh)
- Larja dhe fshirja e dyshemesë së Tualetit
- Pastrimi i karrigeve

2. Shërbime me frekuence 1 - mujore

- Pastrimi i xhamave brenda dhe jashte dhe bordurave të xhamave
- Pastrimi i koshave të plerave.